




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

09 Nr. 104/02-3165/2026

Kaçanik, 05.02.2026

Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e Projekt -Propozimeve të OJQ-ve

Komuna e Kaçanikut, sipas Thirrjes Publike Nr. 09-104/02-2563/26 e datës 30.01.2026, për aplikim për subvencione në fushën e, Rinisë dhe Sportit vitin 2026, dhe Thirrjen sipas thirrjen publike Nr. 09-104/02-3112 të datës 04.02.2026, për aplikim për subvencione në fushën e kulturës, planifikimit ofrojtë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të organizatave joqeveritare në fushat prioritare që ndërthihen me:

- Mbështetja, nxitja, fuqizimi, zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve të përgjithshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit
- Organizimi i ngjarjeve me karakter bashkëpunimi për promovimin e vlerave në fushat e kulturës rinisë dhe sportit
- Përfshirja e të rinjve në aktivitetet kulturor, rinor e sportive;

Përkatësisht :

NË FUSHËN E RINISË DHE SPORTIT:

- Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore për zhvillimin e aktiviteteve me të rinjtë duke u mbështetur në plan programin e Drejtorisë Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2026;
- Përbërja e klubeve sportive publike që funksionojnë në Komunën e Kaçanikut të regjistruara në federatat përkatëse e që marrin pjesë në gzyrtare në vitin 2026..
- Sporti i femrave - zhvillimi dhe pjesëmarrja aktive e femrave në sport, përmes përkrahjes së klubeve, dhe aktiviteteve sportive për vajza dhe gratë promovimin e aktivitetit fizik.
- Sporti rekreativ dhe sporti për të gjithë - mbështeten aktivitetet sportive rekreative që synojnë përfshirjen e të gjitha moshave dhe kategorive shqetërore në sport dhe aktivitet fizik.
- Sporti i të rinjve dhe identifikimi i talentëve -përkrahjen programet për zhvillimin e sportit të të rinjve dhe identifikimin e talentëve sportive, qëllim avancimin e tyre drejt niveleve më të larta të garave.
- Shëndeti dhe siguria e sportistëve,-inkurajohen aktivitetet që kontribuojnë në ruajtjen e shëndetit të sportistëve, parandalimin e lëndimeve dhe sigurimin e kushteve të sigurta gjatë stërvitjeve dhe garave.
- Zhvillimi dhe menaxhimi i klubeve sportive -mbështetet forcimi i kapaciteteve organizative dhe menaxheriale të klubeve sportive për funksionim të qëndrueshëm dhe profesional.

↓ NË FUSHËN E KULTURËS

- Promovimi dhe afirmimi i vlerave kulturore
- Promovimi i krijimtarisë lokale artistike
- Promovimi i trashëgimisë kulturore
- Festivalet, koncertet, shënimet e datave historike kulturore, simpoziumet dhe ekspozitat
- Përkrahja për grupet/shoqëritë kulturo-artistike dhe OJQ-të që funksionojnë në komunën e Kaçanikut, të cilat do të mbështeten, bazuar në realizimin e suksesshëm të programeve të tyre kulturore dhe artistike në vitet paraprake dhe planprogramit të tyre të punës për vitin 2026
- Përkrahje për OJQ-të duke u bazuar në planprogramin e DKRS për vitin 2026 në aktivitetet si : Organizimi i Festivalit të Këngës Popullore për Fëmijë " Kaçaniku Këndon ", Organizimi i Festivalit Kombëtar të SHKA-ve dhe Ansambleve Kulturo-Artistike, Organizimi i Aktivitetit për mërgimtarë " Ju jeni pjesë e Atdheut ", Aktivitetet kulturore për shënimin e datave të rëndësishme në komunën tonë etj...

Rregullojta MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e komisioni vlerësueses për vlerësimin e projektpropozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupet ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, si dhe rregullores Nr.06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjeve subvencioneve. Për këtë qëllim, Komuna e Kaçanikut, fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrit të ekspertëve jashtëm, të cilët sipas nevojës së institucionit do të caktohen në cilësinë e anëtarëve në komisione vlerësuese për të vlerësuar projekt -propozime dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat jodeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur me njohuri dhe kompetenca në fushën e administratës publike, hartimit dhe menaxhimit të projekteve apo fusha të ngjashme

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
 - Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
 - Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin;

Aplikimi mund të bëhet nga data 05.02.2026 deri më datë 17.02.2026 duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kësaj në objektin Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5)

Komuna e Kaçanikut, do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuar për mënyrën e thirrjes publike, do të bëhen pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm të cilët do të ftohen sipas nevojës për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese sipas thirrjes publike që do të bëjë Komuna e Kaçanikut në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë vitit 2025.

Drejtori i DKRS
Lulëza Krastiqi

